**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**

**AC-AKP nr.03/2021**

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarëve, Ragip Namani kryetar i kolegjit, Beshir Islami dhe Jelena Krivokapić, anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sherif Krasniqi, në çështjen juridike **të palës ankuese;**

**F. I. nga ....**
**Sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve,"Sejdiu-Qerkini", me seli ....**
**Kundër:**
**Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, ( tutje, AKKVP),**

Duke vendosur lidhur me Ankesën e paraqitur, kundër Vërejtjes së fundit për Dëbim dhe Kthim të Pronës në Riposedim, të AKKVP, nr. .... të datës 27 maj 2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë, 28 korrik 2021, merr:

**A K T V E N D I M**

Hudhet si e papranueshme Ankesa e F. ., e paraqitur nga përfaqësuesi sipas autorizimit, Shoqëria e Avokatëve,"Sejdiu-Qerkini", kundër Vërejtjes së fundit për Dëbim dhe Kthim të Pronës në Riposedim të AKKVP, nr. ...., të datës 27 maj 2021

**Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike;**

1. Çështja lëndore në shqyrtim në mënyrë kronologjike rezulton se; Drejtoria për Çështje Pronësore Banesore, përkatësisht Komisioni për Kërkesa Pronësore Banesore, (tutje KKPB) i këtij organi, me Vendimin nr. …., të dt. 29 gusht 2003, ka vendosur, që kërkesa e kategorisë "A", DS000153, e palës kërkuese, z. A.L., të aprovohet dhe atij ti kthehet e drejta e pronësore, në banesën lëndore në sip. prej 68.09m2, e cila gjendet në …... Ndërsa palës përgjegjëse në kërkesën e kategorisë "A", për të njëjtën pronë, përkatësisht parashtruesit të kërkesës të kategorisë, "C", DS301793, z. P. K. me të njëjtin vendim Komisioni vendos, që ti njihet e drejta në kompensim si në kuptim të nenit 4, të Rreg. së UNMIK 2000/60, pasi ti kenë plotësuar kushtet sipas pikave të tjera të këtij vendimi. Kurse z. S.I. si banues aktual apo qdo person që e shfrytëzon pronën objekt i kërkesës urdhërohen ta lirojnë të njëjtën në afat prej 30 ditë, në të kundërtën do të dëbohen. (Përmbajtja e vendimit të lartë cekur për kërkesat e palëve konkrete të cekur si më lartë, sipas arsyeve të dhëna në pikën (1), (2), (3), (4), dhe (5) të këtij Vendimi.

2. Kundër vendimit të lartë cekur të shkallës së parë, të KKPB, nr. …., të dt. 29 gusht 2003, kërkesë,(ankesë), për rishqyrtim në shkallën e dytë ka ushtruar P. K.. Komisioni i shkallës së

dytë me vendimin përfundimtar, …., të dt.18 tetor 2006, e refuzon kërkesën e tij, ndërsa e lenë në fuqi vendimin e shkallës së parë ….. të dt. 29 gusht 2003.

3. Nga përshkrimi vendimeve të cekura si më lartë të KKPB, rezulton se palë në procedurë në këtë çështje kontestuese ishin, A. L., P. K.si dhe S. I., i cili ishte banues aktual në pronën lëndore .Tani rezulton se S. I. sipas autorizimit LRP, nr. 22720/17, ref. 4738/17, të dt. 12.12.2017, është autorizuar nga pala ankuese, (ashtu si theksohet në ankesë nga djali tij F.I.), që ta përfaqësoj në të gjitha instancat lidhur me pronën lëndore.

4. Sipas Ligjit 05/L-010, AKKVP, për veq mandatit kryesor të saj, ka trashëguar një pjesë të përgjegjësive dhe të mandatit të Agjencisë Kosovare të Pronës dhe të Drejtorisë për Kërkesa Pronësore dhe Banesore, (**kësaj të fundit kryesisht lidhur me implementimin e vendimeve të sajë të plotëfuqishëm), ashtu si parashihet në nenet 17-19, dhe 22 të këtij ligji.**

5. AKKVP, bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit nr. 05/L-010, të cekura si më lartë, në këtë çështje në kuptim të nenit 6 të U.A.10/2018, i kishte njoftuar palët-ushtruesit e kërkesës "A" dhe "C" për fillimin e implementimit të Vendimit  të plotëfuqishëm nr. …, të dt. 29 gusht 2003. AKKVP kishte pranuar kërkesë nga  A.L. i cili kishte kërkuar kthimin e të drejtës pronësore, sipas Vendimit të KKPB. Agjencia përkatësisht komisioni vlerësues, duke vepruar sipas rregullave dhe procedurave, ashtu si parashihet në nenin 22 par. 5 të Ligjit nr. 05/L-010, në zbatim të Rreg. së UNMIK 2000/60, dhe procedurave të skemës së kompensimit të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ, nr. 10/2018, përkatësisht sipas neneve 10, par.1 dhe 2, nenit 4.4 dhe nenit 6.5 të këtij udhëzimi, në zbatim të vendimit të plotëfuqishëm të Komisionit për Kërkesa Banesore Pronësore, …., ashtu që pas përcaktimit të shumës së privatizimit për banesën lëndore, pagesës së kryer dhe përfundimit të procedurave, lënda i dërgohet Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës për marrjen e vendimit përfundimtar.

6. Me vendimin përfundimtar të Komisionit, nr. ……, të dt. 27 shtator 2019, dhe vendimin individual të vërtetuar, të dt. 10.10.2019, sipas kërkesës së  tij nr. ….., në zbatim të vendimit të plotëfuqishëm, me nr. …… të dt. 29 gusht 2003, A.L. i kofirmohet pronësia mbi pronën lëndore-banesën dhe urdhërohet që i njëjti të regjistrohet si pronar ligjor në shënimet publike përkatëse, nga dita e pranimit të vendimit-urdhërit. Ndërsa çdo person, apo palë përgjegjëse, që pa të drejtë e ka uzurpuar apo gjendet në banesë duhet ta liroi në afat prej 30 ditë, nga dita e paranimit të këtij urdhëri, dhe nëse personi pa të drejtë banimi nuk i bindet urdhërit për lirimin e pronës, brenda afatit të dhënë, do të dëbohet nga prona.

7. Me Vendimin për lirimin e pronës lëndore, …. të dt. 10.10.2019, si dhe Vërejtjen e fundit për Dëbim dhe Kthim të Pronës në Riposedim, …. të dt. 27.05.2021, pala ankuese, banuese në këtë pronë, është njoftuar se deri me datë 04.06.2021, duhet ta liroj pronën lëndore dhe t,ia mundësoi shfrytëzimin e lirë bartësit të drejtës pronësore dhe nëse nuk e liron pronën në afatin e caktuar, AKKVP do ta dëboj pa ndonjë njoftim apo vërejtje tjetër, në datën orën që do të vendoset nga AKKVP-ja.

8. Pala ankuese F. I. për mes përfaqësuesit sipas autorizimit, Shoqëria e Avokatëve, ”Sejdiu-Qerkini” kundër Vërejtjes të fundit të AKKVP, nr. …. të dt. 27.05.2021, e nxjerrë në zbatim të vendimit të plotëfuqishëm të KKPB-së dhe Vendimit përfundimtar KKPK-së, ushtron ankesë në Gjykatë Supreme me të cilën e konteston në tërësi ligjshmërinë e të njëjtes si dhe vendimit të dt. 10.10.2019 me nr. të njëjtë …. duke theksuar ndër të tjera **se;** prona lëndore në Drejtorinë e Kadastrit në Prishtinë sipas aktvendimit të pjesëshëm të dt. 16.01.2014, është regjistruar në emër të P. K. e cila është vërtetuar sipas kontratës së shitblerjes në Gjykatë Komunale nr. Vr. 48/2004, të dt. 06.01.2004, duke u bazuar në Kontratën mbi ndërrimin e banesës, Ob.nr.1856/98, dt.18.05.1998. Se P. K. pasi kishte rënë në kontakt me ankuesin F. I. ia kishte shitur banesën lëndore në sip. prej 68.09.m2, sipas kontratës së shtiblerjes, të noterizuar me nr. ….17, tek Noter, I.Ademi, nr, ref. …..dt.12.12.2017, dhe me Aktvendimin e dt. 10.01.2018, Zyra Kadastrale në Prishtinë në zbatim të kontratës së shitblerjes së cekur si më lartë e regjistron pronën lëndore në emër të palës ankuese sipas Certikifikatës Pronësore, nr. …. dt. 12.01.2018. Se pas kësaj pala ankuese e ka shfrytëzuar i pa penguar pronën lëndore ,deri me dat. 10.10.2019, kur e pranon Vendimin e vërtetuar të AKKVP, me të cilin obligohet ta liroj pronën lëndore në afat prej 30 ditë, gjer sa me të njëtin vendim pales tjetër A.L. i njohet pronësia dhe urdhërohet që banesa të regjistrohet në emër të tij në shënimet publike përkatëse, prandaj me këto veprime tek pala ankuese është shkaktuar pasiguri juridike pasi që ky pronën e ka blerë në mënyrë të ligshme dhe në kadastër është i regjistruar si pronar ligjor, etj. Në fund propozon që ankesa e F. I. të aprovohet si e themeltë, të anulohet Vendimi i AKKVP, …., i dt. 10.10.2021, si i pa bazuar, të anulohet vendimi i AKKVP me nr. ….. dt. 27.05.2021 si i pa bazuar, të ANULOHEN të gjitha veprimet e ndërmarra deri më tani nga AKKVP-së.

**Arsyetimi ligjor;**
-*Juridiksioni***,**

9. Gjykata Supreme, kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e lëndëve sipas ankesës të ish Agjencisë Kosovare të Pronave, tani Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të tjera, të paraqitura nga pala ankuese gjen se, kjo gjykatë nuk ka kompetencë ligjore për të vendosur, lidhur me Vendimet e ish Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore-KKPB-së, dhe as vendimeve konkrete që janë të ndërlidhura me zbatimin e Vendimeve të këtij organi si në rastin konkret të nxjerrë nga KKPK, nr. …., të dt. 10.10.2019, si dhe aktit përfundimtar të cilin e konteston me ankesë, përkatësisht Vërejtjes së fundit të AKKVP ….., të dt. 27.05.2021, të nxjerrë në përfundim të procedurës së ekzekutimit të vendimeve të plotëfuqishme të cekura si më lartë, gjer sa kjo çështje banesore lidhur me kërkesën lëndore …., është vendosur me vendimin si u cek (në parag. 1 dhe 2 të këtij Aktvendimi), nr. …. të dt. 29 gusht 2003, dhe vendimin e shkallës së dytë,(përfundimtar), …., të dt.18 tetor 2006, të KKPB.

10. Sipas Ligjit në fuqi nr.05/-L-010, për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, nuk është e paraparë që vendimet e Drejtorisë për Çështje Pronësore dhe Banesore, përkatësisht Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore në kuadër të kësaj Drejtorie, apo aktet e

tjera të lidhura me këto vendime dhe zbatimimin e tyre, si në rastin konkret, të Vendimit ….. 10.10.2019 dhe Vërejtjes së fundit, …, të dt. 27.05.2021, se mund të jenë objekt i kontestimit qoft me padi apo me ankesë në Gjykatë Supeme, gjer sa sipas neneve 17-19 dhe nenit 22, të këtij ligji AKKVP, ka kompetenca të ekzekutoj vendimet e plotëfuqishme të Komisionit për Kërkesa Pronësore, aktgjykimet e Gjykatës Supreme dhe **Vendimet e Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore**, dhe të bëjë lëshimin dhe ekzekutimin e urdhërit për dëbim të qdo personi që është duke qëndruar në mënyrë të pa ligjshme në një pronë, të vendosur me vendim të plotëfuqishëm të Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore (KKPB).

11. Sipas nenit 2.7, të Rregullores së UNMIK, nr.1999/23, të datës 15 Nëntor 1999, Vendimet e Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore, janë të detyrueshme për tu zbatuar **dhe nuk janë objekt i ri i shqyrtimit nga asnjë organ tjetër gjyqësor apo administrativ në Kosovë.**

12. Vendimi bazë, …, i dt. 29 gusht 2003, i vërtetuar me vendimin e shkallës së dytë, …., të dt.18 tetor 2006, është i plotëfuqishëm, në pajtim me nenin 2, paragraf 7, të Rregullores së lartë cekur, nr. 1999/23, i njëjti nuk mund të ankimohet, në këtë fazë, as sipas Rregullores së UNMIK nr.2000/60, sepse dispozitat e këtyre dy Rregulloreve të cekura si më lartë, si dhe aktet ligjore të më vonshme, dhe tani në fuqi që e rregullojnë këtë lëmi, nuk parashofin ndonjë mjet juridik të rregulltë, apo të jashtëzakonshëm të goditjes ndaj vendimeve përfundimtare të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore.

13. Sipas dispozitave të Rregullores së lartë cekur, nr. 1999/23, pas vendosjes nga Komisioni për Kërkesa Pronësore Banesore me vendim, i cili është bërë i formës së prerë, çështja e vendosur trajtohet, *res judikata* , **sepse sipas nenit 2.5, të kësaj Rregullore, në çështjet e pronave banesore, jurisdiksioni i gjykatave lokale ishte përjashtues, ndërsa komisioni ka kompetenca ekskluzive për të zgjidhë kategoritë e kërkesave të theksuara si në nenin 1.2, të kësaj Rregullore.**

14. Ngjajshëm është edhe jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës sa u përket vendimeve të formës së prerë të Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore, (shih Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, në rastin **me numër, KI 104/10**, e në mënyrë specifike paragrafët, 64-75, të këtij aktgjykimi).

15. Nga të lartë cekurat e në kuptim të nenit 13, par. 1 dhe 2, dhe neni 13. 3 c), të Rregullores së UNMIK, nr. 2006/50, e ndryshuar me Ligjin, nr. 03/L-079, dhe neni 16.3, parag.3.2, të Ligjit 05/L-010, për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Këshilla Juridike;**

16. Sipas nenit 13.6, të Ligjit 03/L-079, ky aktvendim është i plotfuqishëm, i njëjti nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

**GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË**
**AC-AKP nr. 03/2021, me datë 28 korrik 2021**

**Bashkp. Profesional,** **Kryetari i Kolegjit,**
**Sherif Krasniqi** **Ragip Namani**